



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr.10/2020

Datë: 24.01.2020

Prishtinë

Kryeprokurori i Shtetit, në bazë të nenit 1, i cili i referohet nenit 11, paragrafi 1, pika 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, me qëllim të zbatimit të ligjshmërisë dhe rritjes së efikasitetit të punës së prokurorëve dhe në funksion të zbatimit të Ligjit nr. 05/L-030 për përgjimin e komunikimeve elektronike, Rregullores nr.05/2016 për Njësine Ndërlidhëse për Përgjimet dhe nenit 6 të Marrëveshjes së bashkëpunimit për përgjimin e komunikimeve elektronike, të lidhur në mes të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), Policisë së Kosovës (PK) dhe Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), me datë 24 janar 2020, nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE TË
SIGURUARA PËRMES PËRGJIMIT TË LIGJSHËM GJATË HETIMEVE**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë udhëzim administrativ përcaktohen procedurat e shkatërrimit të të dhënave të siguruar përmes përgjimeve të ligjshme gjatë hetimeve.

Neni 2
Lista e dokumenteve që duhet të shkatërrohen

1.Lista e dokumenteve që duhet të shkatërrohen janë si në vijim:

- 1.1 Urdhëresat e pranuar dhe
- 1.2 Formularët.

Neni 3

Pranim – dorëzimi i dokumenteve për shkatërrim

1. Pranim-dorëzimi i dokumenteve bëhet me formën përkatëse, të cilës i bashkëngjiten lista e dokumenteve për shkatërrim.
2. Arsyetimin dhe listën e dokumenteve e përgatit zyrtari i Njesisë Ndërlidhëse, të cilat i dërgohen Kryeprokurorit të Shtetit apo të deleguarit të tij.

Neni 4

Shkatërrimin e të dhënave brenda objektit të përgjimit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

1. Kryeprokurori i Shtetit sipas Vendimit me numër të protokollit: A.nr.460/2016, të datës 14 shtator 2016, me të cilin ka caktuar udhëheqësin e Njesisë Ndërlidhëse për Përgjimet, të njëjtin e autorizon qoftë gojarisht apo me shkrim për shkatërrimin e të dhënave brenda Njesisë Ndërlidhëse, të cilat rezultojnë nga përgjimi i ligjshëm.
2. Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij vendosin për shkatërrimin e dhënave brenda Njesisë Ndërlidhëse, që rezultojnë nga përgjimi i ligjshëm, jo më vonë se dymbëdhjetë muaj pas përfundimit të hetimeve.
3. Çdo e dhënë, e cila merret përmes përgjimit të ligjshëm dhe çdo kopje e saj do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose të shkatërrohet brenda tre muajve kalendarik pasi të mos i shërbejë më hetimeve.
4. Kryeprokurori i Shtetit ose i deleguari i tij mbështetet nga stafi i Njesisë Ndërlidhëse.
5. Pas çdo procesit të shkatërrimit duhet të bëhet raport i veçantë, i cili duhet të përmbajë llojin dhe sasinë e të dhënave të shkatërruara.

Neni 5

Evidentimi i të dhënave të shkatërruara

1. Të gjitha të dhënat, të siguruara nga përgjimi i ligjshëm, që shkatërrohen paraprakisht, duhet të regjistrohen në një bazë të veçantë të të dhënave për shkresat zyrtare të shkatërruara.
2. Bazën e të dhënave për shkresat e shkatërruara dhe procesi i përfshirjes së shënimeve në bazën e të dhënave për shkresat e shkatërruara menaxhohet nga zyrtari administrativ i Njesisë Ndërlidhëse.

Neni 6
Shkatërrimi i të dhënave brenda Qendrës Monitoruese

1. I deleguari i Kryeprokurorit të Shtetit në koordinim me shefin e sektorit të Qendrës Monitoruese në Policinë e Kosovës do të sigurojë që çfarëdo e dhëne që është marrë përmes përgjimit të ligjshëm dhe çdo kopje që mbahet në kuadër të Qendrës Monitoruese do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose të shkatërrohet brenda tre muajve kalendarik, pasi të mos i shërbejë më hetimeve.
2. I deleguari i Kryeprokurorit të Shtetit do të fshijë dhe/ose të shkatërrojë çdo të dhënë të mbetur nga përgjimi i ligjshëm, që mbahet në kuadër të Qendrës së Monitorimit, jo më vonë se dymbëdhjetë muaj pas përfundimit të hetimeve.

Neni 7
Shkatërrimi i të dhënave brenda objektit të përgjimit të Policisë së Kosovës

1. I deleguari i Kryeprokurorit të Shtetit do të monitorojë personalisht shkatërrimin e çdo të dhëne që posedon Policia e Kosovës, të cilat janë marrë përmes përgjimit të ligjshëm dhe çdo kopje e saj do të fshihet në mënyrë të përhershme dhe/ose të shkatërrohet brenda tre muajve kalendarik, pasi të mos i shërbejë më hetimeve.
2. Gjithashtu do të fshijë dhe/ose të shkatërrojë çdo të dhënë të mbetur, që ka rezultuar nga përgjimi i ligjshëm, jo më vonë se nëntë (9) muaj pas përfundimit të hetimeve.

Neni 8
Shkatërrimi i shkresave /urdhëresave të pranuar dhe formularëve

1. Shkatërrimi i shkresave/urdhëresave dhe formularëve kryhen nga i deleguari i Kryeprokurorit të Shtetit, në mbështetje të zyrtarëve të Njesisë Ndërlidhëse.
2. Procesi i shkatërrimit fillon pasi të verifikohen urdhëresat e pranuar dhe formularët që duhet shkatërruar.
3. Dokumentet shkatërrohen në pajisjen e posaçme (makinën grirëse) për t'i bërë të pamundura për lexim. Procedura e njëjtë vlen edhe për dokumente të tjera nëse ka, të cilat, gjithashtu, grihen në makinën përkatëse.
4. Për arsye të ndonjë procesi gjyqësor, ndonjë kërkesë ligjore ose kërkesë tjetër të pashmangshme, atëherë menjëherë duhet ndaluar shkatërrimi i dokumenteve.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryeprokurori i Shtetit.

KRYEPROKURORI I SHTETIT

Aleksandër Lumezi



Udhëzimi i dërgohet:

- Njesisë Ndërlidhëse për Përgjime;
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës.

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikojë në uebfaqen e Prokurorit të Shtetit.